



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 132/2024
Prishtinë, më 2.5.2024, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni dhe Gramos Agusholli, anëtarë.

Munguan: Abelard Tahiri, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Tringa Dreshaj, KDI; Edona Bajrami-Shala, IRI; Natyra Salihaj, EO; Arbëresha Berisha, RTK; Sami Gashi, GP LVV dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 25.4.2024;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-295 për kript-asetet;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që të hiqet nga rendi i ditës, pika: *4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues*, për shkak se grupi i punës ka nevojë ende për disa përmirësime teknike.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetari i Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 25.4.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25.4.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-295 për krypto-asetet

Kryetari theksoi se në bazë të nenit 74, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, Komisioni përgjegjës- raportues, i ngarkuar nga Kryetari i Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim. Komisioni i paraqet Kuvendit, raport me rekomandime për miratim ose mosmiratim të projektligjit. Ai ia kaloi fjalën znj. Mimoza Kusari- Lila, që ta arsyetojnë këtë projektligj para Komisionit, pasi që ka qenë kryesuese e grupit të punës për hartimin e këtij projektligji, pranisë ligjore e Komisionit.

Mimoza Kusari- Lila, tha se pas afro dy viteve, po finalizohet nisma e 6 deputetëve nënshkrues të këtij Komisioni. Ky projektligj, për herë të parë, do të rregullojë tregtimin, posedimin dhe përcakton kushtet e miningu-ut për krypto-asetet, si një valutë virtuale. Jemi munduar të kemi një projektligj, i cili përcakton kornizat e veprimtarisë dhe përcaktimin e parametrave të sigurisë, siç janë shpëlarja e parasë dhe aktivitetet e tjera të jashtëligjshme. Në këtë projektligj kemi pasur mbështetje të drejtpërdrejtë nga Këshilli i Evropës, përmes ekspertëve, të cilët kanë mbështetur në veçanti, pjesën e forcimit të mekanizmave të parandalimit të pastrimit të parasë, transparencën, llogaridhënien dhe financimin e aktivitetet të jashtëligjshme. Propozoj miratimin e tij dhe të procedohet për lexim të parë në seancën plenare.

Pas debatit, Komisioni, me vota unanime, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në shqyrtim të parë Projektligjin nr.08/L-295 për krypto-asetet.

4. Të ndryshme

Kryetari njoftoi se në mbledhjen e ardhshme, do të shqyrtohet raporti vjetor të AKP-së për vitin 2023, pasi që tanimë është proceduar raporti i vitit të kaluar. Ndërkaq, si njoftim, ju bëj me dije që raportimi i ministres Hajdari, është tërhequr nga rendi i ditës, sepse ministrja nuk ka sjellë raport me shkrim, siç jemi dakorduar.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit